



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	03.10.2023
REFERENC-Ë:	23/1615/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"BRICKOS" SH.P.K. Kërminjan i Poshtëm- Ranillug Shfrytëzim të argjilës ne Kërminjan i Poshtëm Ranillug dhe Topanicë- Kamenicë
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,


Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "BRICKOS" SH.P.K. Korminjan i Poshtëm- Kamenicë, me Nr. Prot. 23/1615/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

- Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "BRICKOS" SH.P.K. Kërminjan i Poshtëm- Kamenicë, për veprimtarinë: shfrytëzim të argjilës ne Kërminjan i Poshtëm Ranillug dhe Topanicë- Kamenicë; dhe
- Shtojcën: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/1615/MMPHI

Datë: 03.10.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Vendimit për Pëlqim Mjedisor me Nr. 16/628/1-ZSP/56/16 të lëshuar me dt. 05.04.2016, Vendimit për Pëlqim Mjedisor me nr. 11/2079/1-ZSP-249/11 të lëshuar me dt. 08.12.2011si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore të dt. 25.09.2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "BRICKOS" SH.P.K. Kërminjan i Poshtëm- Kamenicë, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: shfrytëzim të argjilës në ngastrat kadastrale nr. P-71107074-03231-0, nr. P-71107074-03232-0, zona kadastrale Topanicë - Kamenicë, dhe në ngastrat kadastrale nr. 67-0 dhe 84-0, zona kadastrale Kërminjan i Poshtëm Ranillug.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku bëhet shfrytëzimi i argjilës;
 - 2.3. Të i përmbahet kushteve të shfrytëzimit të argjilës sipas përshkrimit në aplikacion;
 - 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;

Faqe 2 nga 3



- 2.5. Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara të cilat shfrytëzohen për bartjes të argjilës;
- 2.6. Pas përfundimit të aktivitetit të behët rehabilitimi i terrenit sipas përshkrimit në aplikacion;
- 2.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI.

Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "BRICKOS" SH.P.K. Kërminjan i Poshtëm- Kamenicë, është konstatuar se Operatori për veprimtarinë: shfrytëzim të argjilës në ngastrat kadastrale nr. P-71107074-03231-0, nr. P-71107074-03232-0, zona kadastrale Topanicë - Kamenicë, dhe në ngastrat kadastrale nr. 67-0 dhe 84-0, zona kadastrale Kërminjan i Poshtëm Ranillug, plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore në dispozitiv është përcaktuar, komfor nën 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nën 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Kamenicë dhe Ranillug;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters

REFERENC-Ë:	23/1615/153/MMPHI-DMMU
DATË/A:	03.10.2023
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Shpend Agaj, kryesues i komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin "BRICKOS" SH.P.K. Kërminjan i Poshtëm- Ranillug, Shfrytëzim të argjilës ne Kërminjan i Poshtëm Ranillug dhe Topanicë- Kamenicë

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokoli: 23/1615/153/MMPHI-DMMU, të operatorit "BRICKOS" SH.P.K. Kërminjan i Poshtëm- Kamenicë, për veprimtarinë: shfrytëzim të argjilës ne Kërminjan dhe Topanicë- Kamenicë.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu /
Department of Environment Protection and Water

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENC-Ë:	23/1615/153/ MMPHI-DMMU				
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI				
CC:	Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Komisioni për Leje Mjedisore				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje ne "BRICKOS" SH.P.K. Kërminjan i Poshtëm- Ranillug Shfrytëzim të argjilës ne Kërminjan i Poshtëm Ranillug dhe Topanicë- Kamenicë				
Nr. i zyrës:	1517	Lokacioni:	Ish pallati i mediave	Data:	03.10.
Br. kancelarije:		Kucni:	Rilindja, Prishtinë.	Datum:	2023
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input checked="" type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input checked="" type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuari Sekretar,

Komisionit për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 3957/23, me nr. prot. 3957-2/2023, të dt. 25.07.2023, duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L- 025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neni 8 i Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori "BRICKOS" SH.P.K. Korminjan i Poshtëm- Kamenicë, ka aplikuar me Nr. Prot. 23/1615/153/MMPHI-DMMU për vazhdimin e Lejes Mjedisore me Nr. 17/2916/ZSP/21/18 të lëshuar me dt. 23.01.2018, për veprimtarinë: shfrytëzim të argjilës në ngastrat kadastrale nr. P-71107074-03231-0, nr. P-71107074-03232-0, zona kadastrale Topanicë - Kamenicë, sipas Pëlqimit Mjedisor me Nr. 16/628/1-ZSP/56/16 të lëshuar me dt. 05.04.2016, po ashtu ka kërkuar te pajiset me leje Mjedisore për shfrytëzimin e argjilës ne ngastrat kadastrale nr. 67-0 dhe 84-0, zona kadastrale Kërminjan i Poshtëm Ranillug, sipas Pëlqimit Mjedisor me nr. 11/2079/1-ZSP-249/11 te lëshuar me dt. 08.12.2011.

Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Pëlqimit Mjedisor me nr. 11/2079/1-ZSP-249/11 te lëshuar me dt. 08.12.2011;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 16/628/1-ZSP/56/16 të lëshuar me dt. 05.04.2016;
- Leje Mjedisore me Nr. 17/2916/ZSP/21/18 të lëshuar me dt. 23.01.2018;
- KPMM- Licencë për shfrytëzimin e argjilës, me nr. 1592/KPMM/2016, të protokolluar me nr. 2605, të lëshuar me dt. 22.06.2016, me afat të vlefshmërisë deri me dt. 13.06.2029, për lokacionin Kërminjan i Poshtëm Ranillug dhe Topanicë-Kamenicë;
- Komuna Ranillug – Pëlqim me të cilin i lejohet eksploatimi i dheut kompanisë "BRICKOS", me nr. 03-3-116/2011, të protokolluar me Nr. Prot. 03-3-186/2011, të lëshuar me dt. 21.09.2011.

Komisioni për Leje Mjedisore ka realizuar vizite te operatori, për verifikimin e kushteve mjedisore me dt. 31.03.2023.

Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës te operatorit në fjalë duke përfshirë aplikacionin, dokumentacionin përcjellës qe nevojitet për pajisje me leje mjedisore dhe gjendjes faktike

në teren, në takimin e mbajtur me dt. 08.06.2023, në përbërje prej pesë (5) anëtareve, unanimisht, kanë dhënë mendim profesional si në vijim:

Operatori i ka sjellë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, gjithashtu operatori i ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe mjedisore dhe si përfundim Komisioni rekomandon që ti lëshohet Leja Mjedisore.

Vërejtje: kjo lënde është kthyer për ri shqyrtim nga ZSP me dt. 19.07.2023 dhe është rishqyrtuar me datë: 25.09.2023 nga komisioni në përbërje prej tre (3) anëtareve.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjëni edhe propozim vendimin për Leje Mjedisore.

Komisioni:


Shpend Agaj, kryesues


Adem Tusha, anëtar


Përparim Terziu, anëtar

Fatmir Bytyqi, anëtar

Illir Kryeziu, anëtar







Gjendet në udhëtim zyrtar jashtë shtetit.

Nuk është prezent në takim.